

PROTOKOLL
MBI MARREVESHJEN PER PERCAKTIMIN E NIVELEVE TE THELLESISE SE
SHTRIRJES SE KONCESIONEVE TE ALBPETROLIT NE THELLESI TE
VENDBURIMEVE QE NDODHEN NE ZONAT E TIJ TE LICENSES.

Ky protokoll mbahen nga dhe ndermjet Agjensise Kombetare te Hidrokarbureve (AKH), Korporates Shqiptare te Naftes (ALBPETROL) dhe Institutit Gjeologjik te Naftes (IGJNG), ku AKH ne perputhje me Ligjin "Per Hidrokarburet 1993", perfaqeson Ministrin i cili aprovon perfundimisht kete Protokoll dhe IGJNG eshte zgjedhur nga te dy palet e tjera ketu si organizem ekspert. Palet ketu bien dakort si me poshte:

1. Objekt i marreveshjes do te jene vendburimet e njohura qe ndodhen ne zonat e perfshira ne licensen e dhena nga Shteti per ALBPETROLIN.
2. Vendburimet e poshteshenuara do ti mbeten ne License ekskluzive ALBPETROLIT, ashtu si gjer me sot. Ne se ka kerkesa per kerkimin e naftes dhe te gazit ne thellesi te tyre tej kufirit te percaktuar per sejcilin vendburim ne piken 3 me poshte nga firmat nderkombetare te naftes, AKH do te kryeje te gjitha procedurat perkatese ne perputje me kerkesat e Ligjit "Per Hidrokarburet", njelloj si per zonat e tjera te lira, qe nuk i jane licensuar ALBPETROLIT.
3. Sipas vendburimeve thellesia maksimale ku do te vazhdoje te shtrihet edhe me tej e drejta e licenses se ALBPETROLIT jepet me poshte :
 - i. Per vendburimet e naftes dhe te gazit ne gelqeroret thellesia maksimale do te llogaritet ne nje nivel 200m nen kontaktin fillestar nafte-ujje.
 - ii. Per vendburimet ranore te naftes Kucove, Patos-Marinez-Bubullime-Kolonje, thellesia maksimale do te merret 100m poshte siperfaqes se shplare qe i ve ata ne kontakt me katin e poshtem
 - iii. Per vendburimet e gazit:
 - iii.a. Divjake, Tortonian, deri 3700m.
 - iii.b. Divjake-Ballaj-Kryevidh, Pliocen, deri ne siperfaqen e shplare te Pliocentit, brenda konturit te vendburimit.
 - iii.c. Frakull deri ne thellesine 2000m.
 - iii.d. Povelce deri ne thellesine 3000m, Pliocen-Torton perfshire.
4. AKH do te njoftoje palet e tjera ketu per cdo propozim qe paraqitet lidhur me objektet e mesiperme te kerkimit dhe palet nga ana e tyre shprehin mirkuptim per kete veprim qe i

sherben avancimit te kerkimeve ne thellesi me te medha se zbulimet tashme te realizuara. AKH dhe ALBPETROLI per cdo zbulim te mundeshem ne keto objekte te reja do te bashkerendojne punen per zhvillimin e tyre dhe perdorimin e infrastrukures qe ALBPETROLI ka marre ne perdorim per shfrytezimin e vendburimeve ekzistuese .

Per IGJNG:	Drejtori:	Dr. Ilia FILI
Per ALBPETROLIN:	Drejtori i Gjeologjise: Drejtori Ekzekutiv:	Dr. Ajet MEZINI Ing. Sokol BEJLERI
Per AKH:	Drejtori:	Ing. Fatbardh ADEMI
Miratohet:	Ministri:	Abdyl XHAJA

Date 29.08.1994